



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministrastvo Administracije lokalne Samopravo
Ministriy of lokal government Administration

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 neni 15 paragrafi 2 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Shpall:

K O N K U R S

Titulli i vendit të punës:	Zyrtar për Integritet Evropian
Departamenti:	Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave
Divizioni:	Integritet Evropian
Orari i punës:	Orar i plotë i punës
Koeficienti:	7
Raporton tek:	Udhëheqësi Divizionit për Integritet Evropian
Lloji i pozitës:	I/E karrierës
Mbikëqyrja e stafit:	0
Referenca:	IE/090

Qëllimi i vendit të punës :

Të ndihmoj dhe këshilloj në përcaktimin dhe vendosjen e prioriteteve të MAPL-së për sa i përket obligimeve që dalin nga procesi i integritetit evropian të Kosovës, në zhvillimin e politikave dhe bashkërendimin e aktiviteteve ndërmjet MAPL-së dhe Komunave me qëllim të zbatimit të kriterëve të BE-së për Kosovën

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Të ndërmarrë veprime të nevojshme dhe të zhvilloj aktivitete në procesin e ngritjes së vetëdijes publike lidhur me kriteret e BE-s;
2. Të nxjerrë sfidat nga Raporti i Progresit për MAPL-në dhe Komunitat;
3. Të nxjerrë obligimet e MAPL-së dhe Komunave nga PVMSA-ja;
4. Të përgatitë raporte të rregullta për MAPL-në dhe Komunitat për sa i përket zbatimit të PVMSA-së;
5. Të përgatis dhe analizoj raportet e takimeve të DPSA-së dhe takimeve të tjera që kanë të bëjnë me procesin e Integritetit Evropian;
6. Të marrë pjesë sipas kërkesës në hartimin e ligjeve dhe urdhërësive nga fushëveprimi i MAPL-së dhe integritetit në BE;
7. Të bashkëpunojë dhe të ndërlihdë në mënyrë të efektshme punën, ashtu siç kërkohet me zyrtarët nga departamentet tjera;
8. Të sigurojë komunikim dhe informim efektiv brenda ministrisë dhe komunave lidhur me aktivitetet që kanë të bëjnë me çështjet e integritetit evropian;

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara: *(kualifikimet, përvoja dhe aftësitë e shkathtësitë tjera të kërkuara për të kryer këtë punë)*

Diplomë universitare në Drejtësi, Ekonomi dhe Administrim Publik ose në ndonjë fushë tjetër që ka të bëjë me integrimet evropiane.

Së paku 2 vite përvojë pune.

Të ketë njohuri të institucioneve dhe politikave të BE-së, veçanërisht të politikës së integriteteve evropiane;

Të jetë i aftë të punojë në mënyrë të efektshme dhe t' i përmbush afatet;

Të jetë i aftë të punojë i pavarur dhe si pjesë e ekipit (ekipi punues);

Njohje e gjuhës zyrtare;

Njohje e gjuhës angleze ;

Njohje e kompjuterit (Microsoft Office, Internet).

Aktet ligjore dhe aktet nën –ligjore që rregullojnë rekrutimin

Rekrutimin e nëpunësve civil e rregullon Ligji Nr. 03/L -149 Për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Rregullorja Nr.02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil .

Kohëzgjatja e emërimit

Kohëzgjatja e emërimit-punësimit është në përputhje me LSHCK Nr. 03/L-149, në të cilën është e përfshirë periudha e punës provuese njëvjeqare.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve

Formularët zyrtar për aplikim merren në Divizionin e Burimeve Njerëzore të MAPL-së, Kati XII -zyra 1203 , ndërtesa e ish-Rilindja, gjithashtu mund të tërhiqen edhe nga ueb -Faqja e MAPL -së . mapl.rks-gov.net.

Kushtet për pjesëmarrje në rekrutim

Aplikacionet e plotësuar së bashku me kopjet e dëshmive për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat dhe Vërtetimin nga Gjykata që personi nuk është nën hetime etj, mund të dorëzohen drejtpërdrejtë në Zyrën e Personelit të MAPL-së dhe përmes postës.

-"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë",

-"Komunitet jo- shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11,pragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikë së Kosovës"

-Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

-Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

Procedura e Konkurimit

Procedura e konkurimit është e jashtme dhe të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit.

Konkursi dhe kërkesa për punësim janë të publikuara edhe në ueb-Faqen e Ministrisë:

mapl.rks-gov.net

Për informata shtesë mundë të kontaktoni Divizionin e Burimeve Njerëzore të MAPL-së, në telefonin: 038-200 35-568.